

## 1.

Në shkurt të vitit 2020, shkova ushtar në Afganistan. Na vendosën në Herat.

Herati është një qytet me gati gjysmë milioni banorë dhe jam i bindur që gazetatat perëndimore e përshkruajnë si një vend ku ka pak diell dhe shumë gjak. Në të vërtetë nuk ishte fare kështu. Dielli ishte i plotë dhe natën kishte një zagushi të ëmbël e cila ta rrethonte qafën me një djersë të freskët ledhatuese. Ditën mund të dilnim në parqet e gjera të Heratit duke ngrënë pite dhe qebap, vaji i të cilave mund të shtrydhet në një shishe pepsi, ndërsa pasditet i mbushnim me ushtrime fizike nën qiellin e lagësht të Azisë.

Përveç qendrës së Heratit, e cila kishte pamjen e një vendi të organizuar me rrugë të gjera, me muze, stacione autobusësh dhe dyqane të mëdha, pjesa tjetër e qytetit ishte krejtësisht e shkatërruar. Gjatë viteve kur amerikanët sulmonin talebanët nga ajri Herati ishte bombarduar, aq sa nëpër lagjet e periferisë ishte pothuajse e pamundur të hyje nga pirgjet e gurëve dhe mbetjeve, si dhe nga makinat e djegura që dukeshin si skelete metalike të zhveshur nga sytë, nga dhëmbët dhe lëkurët.

Si çdo qytet i pushtuar, Herati ishte i ndarë në dy pjesë. Amerikanë dhe të tjerë. Amerikanët e shijonin qytetin ditën, afganët e jetonin natën. Burrat dilnin natën nga shtëpitë dhe shkëmbenin para, mall ose barcaleta për amerikanët, ndërsa gratë lanin rrobat, shtëpitë dhe veten. Nuk e di pse qyteti punonte më shumë natën. Ishte një zakon që u kishte mbetur nga ditët e vështira të bombardimeve ose edhe më parë, nga koha e talebanëve apo ndoshta edhe nga koha e rusëve. Thoshin se ushtarët rusë kishin qenë përtacë dhe natën flinin pasi pinin shumë gjatë ditës dhe kështu ua linin të gjithë qytetin afganëve për ta shijuar. Ushtarët amerikanë talleshin kur thoshin, se nëse do të shkosh me gratë e Heratit duhet të presësh të iki dielli nga qielli dhe jo burri nga shtëpia. Në të vërtetë për gratë e Heratit thuheshin shumë fjalë që nuk ishin vetëm sajesa të amerikanëve të shturur, por kryesisht vinin nga vetë afganët që besonin se Herati ishte

qyteti më liberal dhe poetik që kishin patur në histori, një vend ku gratë njiheshin për epshin dhe lirinë e tepruar, çka mund ta vërtetoje me shumë pak pará duke vizituar shtëpitë e kuqe të qytetit.

Ndërsa burrat e Heratit ishin paqësorë, pavarësisht se pak të ngathët. Dukej sikur përtonin të luftonin. Në këtë qytet rezistenca ndaj amerikanëve ishte më e fjetur, çka shpjegohej me natyrën e kufizuar të burrave dhe karakterin konformist të grave për ta mbajtur mirë me të huajt. Amerikanët dhe ne të tjerët, që plotësonim numrin e domosdoshëm të ushtarëve të huaj në Afganistan, ishim kthyer në ekonomi. Qyteti jetonte nga paratë që ne harxhonim duke blerë mish, ujë, ushqime dhe gra. Amerikanët besonin se përfundimisht ata e kishin shtruar Afganistanin, duke zhdukur talebanët me ndihmën e një qeverie kukull që kishin krijuar në Kabul. Megjithatë duhej të jetoje pak kohë nëpër provincat afgane për të kuptuar se kjo nuk ishte e vërtetë.

Meqë gjatë shekullit të kaluar aty janë bërë eksperimentet më të mëdha ushtarake, Afganistani është vendi ku po gatuhet një ideologji e panjohur antiamerikane që, me sa kuptoj, po përhapet me shpejtësi edhe jashtë këtij vendi. Unë mendoja se të ishte antiamerikan ishte një mëkat i padrejtë dhe i ndëshkueshëm. Në Shqipëri amerikanizmi ishte kthyer në një fe. Qeveritë tona bënin

gjithçka që mundeshin, për t'u pëlqyer amerikanëve dhe nëse dikush konsiderohej antiamerikan kjo ishte njëlloj si të quheshe heretik në Mesjetë. Mund të përfundoje pa punë dhe i damkosur keq si një njeri që nuk donte stabilitetin e vendit, drejtësinë dhe demokracinë, që vinte përtej oqeanit në formën e një reje, nga e cila ishte gabim të mbroheshe. Amerika ishte një kontinent në të cilin nuk jetonim dot fizikisht, por shpirtërisht e ndanim me treqind milionë amerikanët e tjerë. Një nga oficerët tanë thoshte shpesh se Amerika ishte *our second better home*. Shqiptarët mendohej se ishin populli më proamerikan jashtë Amerikës dhe mua më vinte mirë që isha njëri prej tyre. Ata paguanin rrogat tona, na ushqenin, na vishnin, na mësonin artin e luftës duke na bindur se edhe në Afganistan ne po luftonim për Amerikën.

Tri ishin fjalitë që çdo ushtar duhej t'i dinte: Azia ishte nëna e frikës, Evropa ishte nëna e lirisë, ndërsa Amerika ishte nëna e demokracisë dhe meqenëse demokracia është një hap më i avancuar i lirive njerëzore ne duhej ta mbronim atë me jetët tona. Kështu na mësonin në ushtri. Unë e doja Amerikën sepse nuk kisha asnjë arsye të mos e doja. Por në Afganistan nuk ndodhte kështu.

Urrejtja e afganëve për amerikanët ishte kthyer në një traditë. Tradhtarët ishin me Amerikën ndërsa heronjtë luftonin kundër saj. Në përgjithësi afganët e kanë humbur mundësinë për të dashur dhe urrejtja është ndjenja më

e fortë që drejton shpirtin e atij populli. Urrejtja e tyre ishte e butë, e njomë dhe e mëndafshtë si qilimat persianë të Heratit dhe atë mund ta shihje si shkëlqim në sytë e fëmijëve që mblidheshin rrotull kampit për të shkruar në gjuhën e tyre fjalë të rënda për të gjithë ne. Shumica e ushtarëve që shërbenin në Herat në të vërtetë nuk ishin amerikanë, por afganët nuk kishin më dëshirë të bënin dallime duke na klasifikuar të gjithëve si pushtues të huaj. Përfshi edhe ne shqiptarët.

## 2.

I pari njeri që më foli kundër amerikanëve çuditërisht nuk ishte një afgan. Ishte një shqiptar. Quhej Winston Harasani dhe e urrente modën e shpifur që kishte detyruar prindërit e tij ta quanin me atë emër, që sipas tij shkonte me mbiemrin, aq sa ç'mund të shkonte fjala hurmë me fjalën kauçuk.

Une jam një hurmë kauçuku thoshte shpesh dhe qeshte me veten. Bënte shumë shaka dhe nëse nuk do e kishte këtë zakon, jeta e tij do ishte rrezikuar më pak, bashkë me jetën e atyre që e donin. Nëse unë nuk shpëtova dot nga ndikimi i humorit të tij magnetik, kjo ndodhi për shkak se unë, në përgjithësi, nuk dija të qeshja. Këtë mungesë nuk e përdora dot si mburojë, por përkundrazi, si një tërheqje ndaj valëve shkatërruese që Uinston Harasani u provua se mund të kishte në jetën time.